

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 13, datë 4.6.2026

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE SHITESË PËR TËRHEQJEN E NËNPRODUKTEVE TË VERËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 15, të ligjit nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”,

UDHËZOJMË:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim i përbashkët i ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ministrit përgjegjës për mjedisin, në vijim “udhëzimi”, përcakton produktet e përftuara nga distilimi, rregullat dhe detyrimet që duhet të plotësohen për trajtimin e tyre, sipas formateve përkatëse për tërheqjen e mbikëqyrur, në përputhje me përcaktimet e pikës 7, të nenit 15, të ligjit nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”, në vijim “ligji”, si dhe me pikën 1, neni 7, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllim të zbatimit të rregullave, termat e përdorur në këtë udhëzim kanë kuptimin e dhënë në shkronjën “c”, pika 13, pika 20.7, si dhe pika 22, të nenit 2, të ligjit nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”.

2. “Distiluesit” janë subjektet që operojnë një distileri dhe që njihen si të tillë sipas legjislacionit në fuqi.

3. Termi “ligj” është përdorur për ligjin nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”.

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

1. Pa cenuar dispozitat e shprehura në specifikimet për verërat me EOM dhe TGJM, që mund të lejojnë përdorimin tradicional të bërsisë në fermentimin e vetë verërave, në përputhje me nenin 15 të ligjit, presimi i thellë i rrushit, presimi i llumit të verës dhe fermentimi i bërsisë për qëllime të tjera përveç distilimit janë të ndaluara.

2. Prodhuesit dhe ata që e kanë përpunuar rrushin në çfarëdo mënyre janë të detyruar t’ia dorëzojnë nënproduktet që rezultojnë nga procesi (llumin dhe bërsinë) një distiluesi ose, në rastet e treguara në nenin 6, të këtij udhëzimi, tërheqjes së mbikëqyrur.

Neni 4

Subjektet e përjashtuara

Përjashtohen si nga detyrimi për të dorëzuar nënproduktet në distileri ashtu edhe nga detyrimi për t’i tërhequr ato nën mbikëqyrje:

a) subjektet që kryejnë çdo përpunim rrushi deri në një maksimum prej 6,000 kg ose që prodhojnë deri në 50 hl verë ose musht në stabilimentet e tyre;

b) prodhuesit e verërave të gazuara aromatike cilësore dhe verërave të gazuara dhe gjysmë të gazuara aromatike cilësore të prodhuara në rajone të caktuara, të bëra me musht rrushi ose musht rrushi pjesërisht të fermentuar të blerë dhe që u nënshtrohet trajtimeve stabilizuese për të hequr llumrat.

Neni 5

Afatet

1. Dorëzimi te distiluesit, duke përfshirë dorëzimin në qendrat e grumbullimit të përkohshme jashtë fabrikës, ose tërheqjen e mbikëqyrur, sipas nenit 6 të këtij udhëzimi, do të bëhet:

a) për bërsitë, brenda 30 ditëve, të zgjatur deri në 90 ditë për prodhuesit e sasive më të ulëta se 1,000 hektolitra, nga 31 dhjetori i vitit të verës;

b) për llumrat, deri më 31 korrik të çdo viti vere, siç përcaktohet në pikën 5, të nenin 15, të ligjit.

Prodhuesit dhe ata që kanë përpunuar rrushin në çfarëdo mënyre duhet të regjistrojnë operacionet e prodhimit, dorëzimit dhe mbledhjes, në përputhje me dispozitat e nenit 16 të ligjit.

2. Dorëzimi i verës, në përmbushje të detyrimit, te distiluesit ose prodhuesit e uthullës bëhet deri më 31 gusht.

Neni 6

Karakteristikat

1. Nënproduktet e prodhimit të verës në kohën e dorëzimit ose të tërheqjes nën mbikëqyrje duhet të kenë karakteristikat minimale të mëposhtme:

a) bërsitë: 2.8 litra alkool anhidrik (efektiv dhe potencial) për 100 kg;

b) llumra vere: 4 litra alkool anhidrik për 100 kg, 45% lagështi.

Llumrat denatyrohen duke shtuar klorur litiumi në një masë prej 5 deri në 10 gramësh për 100 litra produkt, ose duke shtuar klorur natriumi.

Llumrat e verës të destinuara për përdorim agronomik denatyrohen me shtim të sulfatit të hekurit për përdorim bujqësor.

2. Sasia e alkoolit e pranishme në nënproduktet e verës, në raport me vëllimin e alkoolit që përmbahet në verë, është të paktën 5% për verën e përftuar nga vinifikimi i drejtpërdrejtë i rrushit, verën e përftuar nga vinifikimi i mushtit të rrushit, mushtit të rrushit pjesërisht të fermentuar ose verës së re ende në fermentim.

3. Rritja e vëllimit të verës së përftuar nga përdorimi i mushtit të përqendruar ose mushtit të përqendruar të retifikuar për të rritur fortësinë alkoolike të verës dhe për ta ëmbëlsuar atë nuk merret parasysh për qëllimet e llogaritjes së përqindjes së lartpërmendur prej 5%.

4. Për të përcaktuar vëllimin e alkoolit të përmbajtur në nënprodukte krahasuar me atë të përmbajtur në verën e prodhuar, fortësia natyrale alkoolike standarde, sipas vëllimit që duhet të merret në konsideratë në zonat e ndryshme të kultivimit të rrushit është e përcaktuar, në:

a) 9.0% për zonën C I;

b) 9.5% për zonën C II;

c) 10.0% për zonën C III.

5. Nëse përqindjet e treguara në pikën 2 të këtij neni nuk përmbushen, subjektet që duhet të asgjësojnë nënproduktet duhet të dorëzojnë një sasi të verës së tyre të mjaftueshme për të siguruar përputhshmërinë ligjore. Vera denatyrohet me klorur natriumi, nëse mbajtësi synon ta dërgojë atë në një fabrikë uthulle, ose me klorur litiumi nëse mbajtësi synon ta dërgojë atë në një distileri. Detyrimi mund të përmbushet duke dorëzuar verë të prodhuar vetë në fabrikën

e uthullës pa e denaturuar. Në këtë rast, sasia e alkoolit të verës së dorëzuar për këtë qëllim zbretet nga sasia e alkoolit në verën që duhet të distilohet.

6. Përveç dispozitave të nenit 6 të këtij udhëzimi, transporti i bërsisë dhe llumrave brenda territorit shtetëror shoqërohet me dokumentin e përmendur në nenin 38 të ligjit.

Neni 7

Tërheqja e mbikëqyrur

1. Prodhuesit dhe ata që kanë përpunuar rrush në çfarëdo mënyre, të cilët janë të detyruar të asgjësojnë nënproduktet, përmbushin detyrimin e tyre duke i dorëzuar ato, tërësisht ose pjesërisht, në distileri ose me anë të tërheqjes së mbikëqyrur për përdorimet alternative të mëposhtme:

a) përdorim i drejtpërdrejtë agronomik, nëpërmjet shpërndarjes së nënprodukteve në tokë bujqësore, deri në një limit prej 3,000 kg për hektar sipërfaqe bujqësore të regjistruar në dosjen e subjektit, me kusht që të ketë një angazhim të shprehur për të përdorur nënproduktet për qëllime agronomike.

Asgjësimi i nënprodukteve për qëllime agronomike mund të arrihet edhe nëpërmjet kompostimit paraprak në fermë, me kusht që kjo të kryhet jashtë kantinës ose objektit të prodhimit të verës;

b) përdorim indirekt agronomik, nëpërmjet përdorimit të nënprodukteve për përgatitjen e plehrave;

c) përdorim për energji dhe industri, nëpërmjet përdorimit të nënprodukteve si biomasë për prodhimin e biogazit, ose për të furnizuar me karburant impiantet e prodhimit të energjisë, të përdorura, gjithashtu, së bashku me burime të tjera energjie të destinuara për prodhimin e biogazit, ose të biomasës së djegshme, pa cenuar rregulloret aktuale tatimore, si dhe për prodhimin e materialeve inovative;

ç) përdorimi për ushqim, nëpërmjet përdorimit të nënprodukteve për përgatitjen e pijeve ose produkteve ushqimore;

d) përdorim farmaceutik, nëpërmjet përdorimit të nënprodukteve për përgatitjen e barnave;

e) përdorim kozmetik, nëpërmjet përdorimit të nënprodukteve për përgatitjen e produkteve kozmetike;

f) përdorime të tjera alternative të komunikuara autoritetit përgjegjës për ushqimin të paktën tridhjetë ditë para tërheqjes së parë të mbikëqyrur.

2. Nënproduktet e përfuara nga përpunimi i rrushit të verës në produkte të tjera, ndryshe nga mushti dhe vera, i nënshtrohen tërheqjes së mbikëqyrur. Në këtë rast, neni 5 i këtij udhëzimi nuk zbatohet.

3. Prodhuesit dhe ata që kanë kryer ndonjë përpunim rrushi dhe që synojnë të përdorin nënproduktet për përdorime alternative, siç përmendet në pikën 1 të këtij neni, duhet të njoftojnë tërheqjen e mbikëqyrur të nënprodukteve. Njoftimi duhet të dërgohet jo më vonë se katër ditë para fillimit të operacioneve të tërheqjes në rrugë elektronike në zyrën rajonale të autoritetit përgjegjës për ushqimin, sipas formularit në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili duhet të përmbajë:

a) natyrën dhe sasinë e nënprodukteve;

b) vendin ku ato ruhen;

c) llojin e destinacionit;

ç) ditën dhe orën e fillimit të operacioneve që synojnë t'i bëjnë nënproduktet të papërshtatshme për konsum njerëzor, ose ditën dhe orën e fillimit të transportit në objektin ku do të përdoren nënproduktet. Nëse asgjësimi i nënprodukteve ndodh në harkun e disa ditëve, duhet të tregohet edhe plani i tërheqjes/dorëzimit të nënprodukteve;

d) në rastin e përdorimit agronomik të nënprodukteve, angazhimi i prodhuesit për shpërndarjen e tyre në tokën bujqësore, siç është regjistruar në regjistrat e subjektit;

e) në rastin e përdorimit të nënprodukteve nga një palë tjetër, përveç prodhuesit, duhet të tregohet edhe emri, kodi NUIS i kompanisë marrëse, si dhe adresa e saj.

4. Transporti i nënproduktit të mbledhur shoqërohet me një kopje të njoftimit, sipas pikës 3 të këtij neni dhe duhet të paraqitet në rast kërkesë nga organi që mbikëqyr operacionet e mbledhjes. Njoftimet ruhen për një periudhë pesëvjeçare.

Neni 8

Fabrikat e uthullës

1. Fabrikat e uthullës, që marrin verë nga prodhuesit, duhet të lëshojnë, brenda dhjetë ditëve nga dorëzimi i verërave, një certifikatë që përmban të paktën informacionin e listuar në shtojcën II, të këtij udhëzimi, që duhet të plotësohet në tri kopje, për t'u dërguar siç tregohet në shënimin në fund të faqes së vetë modelit.

2. Dorëzimi i verës në fabrikën e uthullës, në përmbushje të detyrimit të përmendur në nenin 5 të këtij udhëzimi, bëhet deri më 31 gusht të vitit pasardhës, të vitit në të cilin është marrë rrushi.

Neni 9

Kontrollet

1. Fortësia alkoolike, e përcaktuar për distilimin e bërsisë, llumit dhe, kur është e aplikueshme, verës së dërguar për distilim ose prodhim uthulle, ose për përdorimet e parashikuara në nenin 6, të këtij udhëzimi, përcaktohet për gradë/100 kilogramë për bërsinë dhe llumin, ose për gradë/hektolitër për verën.

2. Distiluesit, ose subjektet e tjera të autorizuar, sipas nenit 6 të këtij udhëzimi, për të marrë bërsi dhe llum duhet të verifikojnë, pas hyrjes, për secilin furnizues dhe për secilën dërgesë, që lënda e parë e importuar përmbush të paktën kërkesat minimale të përcaktuara në nenin 5, të këtij udhëzimi.

3. Transporti i përbashkët i nënprodukteve nga prodhues të shumtë lejohet me kusht që të lejojë identifikimin e furnizimeve individuale, ose të kryhet në një mënyrë që lejon që furnizimet të mbahen të ndara.

Neni 10

Produktet e përfthuara nga distilimi

1. Nga distilimi i nënprodukteve të prodhimit të verës mund të përftohen produktet e mëposhtme:

a) alkool etilik me origjinë bujqësore që përmbush kërkesat e legjislacionit për pijet alkoolike;

b) distilat me origjinë bujqësore, siç parashikohet nga legjislacioni për pijet alkoolike;

c) raki nga bërsi rrushi që përmbush përkufizimet e legjislacionit për pijet alkoolike;

ç) alkool me një fortësi alkoolike në vëllim prej 92% ose më të lart;

d) raki nga llum vere që përmbush përkufizimet e legjislacionit për pijet alkoolike.

2. Nëse distiluesit synojnë të tregtojnë raki, dokumenti shoqërues për bërsinë përmban informacion specifik në lidhje me origjinën dhe prejardhjen e lëndëve të para të përdorura, dhe konkretisht varietetin, zonën gjeografike në të cilën është prodhuar dhe vinifikuar rrushi nga i cili është marrë dhe emrin e verës me një emërtim origjine, ose një tregues gjeografik, procesi i vinifikimit të së cilës përbën nënproduktin. Në rast të transportit të përbashkët të shumë

grupeve bërshish të përmbajtura në kontejnerë të veçantë nga i njëjti dërgues tek i njëjti marrës, lejohet përdorimi i një dokumenti të vetëm shoqërues që përmban informacionin e përmendur në këtë paragraf. Distiluesit duhet të regjistrojnë informacionin e përmendur në këtë paragraf në regjistrin e mbajtur në përputhje me dispozitat e rregulloreve të akcizës.

Neni 11

Detyrimet

1. Distiluesi dhe ata që janë të autorizuar për të përdorur bërshitë dhe llumrat sipas nenit 6 të këtij udhëzimi, duhet t'i japin prodhuesit, si provë të dorëzimit, deri më 30 shtator, një certifikatë përmbledhëse, që tregon të paktën natyrën, sasinë dhe fortësinë alkoolike në vëllim të produktit të dorëzuar, si dhe datat e dorëzimit.

2. Në dorëzimin e verës për përmbushjen e detyrimit për vitin e kaluar të verës, lëshohet një certifikatë e veçantë brenda dyzet e pesë ditëve nga mbërritja e verës në distileri.

3. Certifikata duhet të përmbajë të paktën informacionin e përcaktuar në shtojcën III të këtij udhëzimi, i cili duhet të plotësohet në tri kopje dhe të dorëzohet siç tregohet në shënimet në fund të faqes së vetë formularit. Informacioni i raportuar në certifikatë korrespondon me atë të raportuar në regjistrat e mbajtur në distileri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për akcizën.

4. Nëse distilimi kryhet nga një distilues që është, gjithashtu, prodhues, certifikimi i përmendur në pikën 3 të këtij neni lëshohet nga zyra rajonale e autoritetit përgjegjës për ushqimin.

Neni 12

Mbikëqyrja e operacioneve të distilimit

1. Mbikëqyrja e karakteristikave të produkteve të dorëzuara për distilim, në veçanti sasia dhe fortësia alkoolike, kryhet në bazë të:

a) dokumentit, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 6 të këtij udhëzimi, nën mbulimin e të cilit u krye transporti;

b) një analize të kryer mbi mostrat e marra me hyrjen në distileri me anë të një mostre përfaqësuese nën mbikëqyrjen e autoriteti përgjegjës për ushqimin. Mostra mesatare merret për çdo 1,000 tonë nënprodukte të futura. Nëse distiluesi prodhon alkool sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, pika 1, të nenit 10, të këtij udhëzimi, marrja e mostrave kryhet për çdo 500 tonë nënprodukte të futura.

2. Inspektimi kryhet me anë të marrjes së mostrave, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në lidhje me:

a) dorëzimin e nënprodukteve në distileri:

- mbi karakteristikat e nënprodukteve dhe çdo vere të dorëzuar si plotësim i detyrueshëm;

- mbi sasinë e dorëzuar;

- mbi përputhshmërinë e informacionit të treguar në certifikatën e kërkuar nga pika 3, neni 11, i këtij udhëzimi me të dhënat e regjistruara në regjistrat e distilerisë;

b) me prodhimin: duke certifikuar karakteristikat cilësore dhe sasiore të alkoolit të prodhuar dhe datën e distilimit.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje midis prodhuesit dhe distiluesit, fortësia alkoolike përcaktohet nga laborator i autoritetit përgjegjës për ushqimin. Shpenzimet përkatëse të analizës do të përballohen nga palët dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë.

Neni 13

Dispozita të fundit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit, si dhe institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, i përcaktuar në nenin 5 të ligjit.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla

MINISTËR I MJEDISIT

Sofjan Jaupaj

SHTOJCA I

NJOFTIM PËR PËRDORIMIN ALTERNATIV NË VEND TË DISTILIMIT TË NËNPRODUKTEVE TË VINIFIKIMIT

Drejtorisë rajonale të autoritetit përgjegjës për ushqimin _____

I NËNSHKRUARI, PËRFAQËSUESI LIGJOR:									
NR. PERSONAL									
MBIEMRI:					EMRI:				
VENDI I LINDJES:					DATA E LINDJES:				
REZIDENCA	ADRESA:								
	BASHKIA:					KODI POSTAR:			
	TEL.					EMAIL			

NGA SUBJEKTI (Të dhënat e subjektit):						
NUIS:						
EMRI:						
FORMA JURIDIKE:						
ME SELI NË	ADRESA:					
	BASHKIA:			KODI POSTAR:		Qarku:
	TEL.		EMAIL			
	NJËSIA PRODHUESE ËSHTË NË TË NJËJTIN VEND			Po	☐	Jo
					☐	

NJOFTON

Që në ditën/ditët _____, të vitit të vjeljes _____, do të kryejë përdorimin alternativ veç distilimit të nënprodukteve të vinifikimit të përfituara nga përpunimi i rrushit (vendosni shenjë në kutitë përkatëse):

1. ☐ në impiantet e veta;
2. ☐ në impiantet e subjektit/prodhuesit _____ me NUIS _____.

Me seli të impiantit në rrugën _____,
njësia administrative _____ (të jepet adresa e plotë).

Që sasia e rrushit e përpunuar gjatë fushatës së vjeljes _____ është _____ kv, nga të cilët _____ kv, janë rrush i pronësisë së vet;

Që sasia e verës e prodhuar gjatë vitit _____ parashikohet të jetë _____ hl.

Përdorimi alternativ i nënprodukteve është si vijon:

☐ shpërndarja për përdorim agronomik; kjo shpërndarje kryhet në sipërfaqe bujqësore, referencat kadastrale të të cilave janë të regjistruara në librin e fermerit, dhe në sasi që nuk tejkalojn _____ kv/ha;

☐ shpërndarja për përdorim agronomik; kjo shpërndarje kryhet në sipërfaqe bujqësore të subjektit/prodhuesit të përmendur në pikën 2, referencat kadastrale të të cilës janë të regjistruara në librin e fermerit, dhe në sasi që nuk tejkalojn _____ kv/ha, sipas deklaratës/deklaratave të bashkëngjitura;

☐ përdorimi për prodhimin e energjisë; nënproduktet dorëzohen në impiantin e prodhimit të energjisë që ndodhet në rrugën _____, bashkia. NUIS _____ *

☐ Tjetër (përshkrimi i përdorimit alternativ) _____

Vendi ku produktet janë depozituar para se të dërgohen për përdorim alternativ veç distilimit, ndodhet në rrugën _____, bashkia _____.

Kodi i regjistrimit të hyrje-daljeve të nënprodukteve të destinuara për tërheqje nën kontroll, është _____.

Nënproduktet e destinuara për përdorim alternativ ndaj distilimit janë:

Emërtimi	Përdorim Bujqësor (Kg)	Përdorim Energjie (Kg)	Përdorime të tjera (Kg)	Karakteristika	
				Alkool (total/100kg)	Lagështia (vetëm për llumërat) %
Bërsi					
Llumra					

Unë, i nënshkruari,
deklaroj se jam i vetëdijshëm për sanksionet penale të parashikuara në rast deklarimesh të pavërteta apo falsifikimesh në dokumente, si
dhe për humbjen e çdo përfitimi të mundshëm;
angazhohem të lejoj – në çdo moment dhe pa kufizime, hyrjen në ndërmarrje dhe konsultimin e dokumentacionit të lidhur ngushtë me
ndërhyrjen nga organet e ngarkuara për kontrollet.

Vendi dhe data _____

Firma _____

(emër mbietmër firmë)

Njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale

Të gjitha të dhënat e paraqitura ruhen në përputhje me "Kodi mbi përpunimin e të dhënave personale" dhe do të përdoren vetëm për qëllime
institucionale nga administrata publike.

Gjithashtu, deklarohet se respektohen dispozitat ligjore mbi sigurinë e të dhënave, dhe se të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit
do të kontrollohen në mënyrë që të minimizohen rreziqet e shkatërrimit, humbjes aksidentale, hyrjes së paautorizuar apo përdorimit të
palejuar.

BASHKËNGJITET FOTOKOPJA E LEXUESHME E NJË DOKUMENTI IDENTITETI TË VLEFSHËM.

SHTOJCA II

DËSHMI DORËZIMI (1)

Dëshmia nr. _____

Prodhuesi subjekt i detyrimit (2) me NUIS
me banesë ose seli në
ka dorëzuar gjatë vitit tek fabrika e uthullës
me NUIS | sasi të mëposhtme të verës:

..... hl. të tipit të ardhura nga zona (3)
me % alkooli efektive për një sasi totale gradësh alkoolike për
prodhimin e uthullës, në lirim të pjesshëm të detyrimit të tij lidhur me vitin e verës.....

Të dhënat e dokumentit shoqërues (4).....

Data

Dorëzuesi

Për fabrikën e uthullës

-
- (1) Dëshmia plotësohet në tre kopje: e para i jepet çdo prodhuesi dorëzues brenda dhjetë ditëve nga dorëzimi i verës; e dyta i dërgohet me email zyrtar, në momentin e lëshimit, zyrës rajonale kompetente të autoritetit përgjegjës për ushqimin në lidhje me vendndodhjen e prodhuesit dorëzues; e treta ruhet në arkivin e fabrikës së uthullës.
- (2) Të shënohen të dhënat e plota ose emërtimi i personit juridik dhe kodi fiskal.
- (3) Të shënohet zona CI, CII ose CIII.
- (4) Të shënohet data dhe numri i dokumentit.

SHTOJCA III

DËSHMI DORËZIMI (1)

Dëshmia nr. _____

Prodhuesi subjekt i detyrimit (2) me NUIS

me banesë ose seli në.....

ka dorëzuar gjatë vitit tek distileria.....

sasitë e mëposhtme lëndëve të verësnë përmbushje (3)

të detyrimit për vitin e verës.....



Lënda e parë (4)	Numri i regjistrimit	Data e regjistrimit në regjistrin e hyrje-daljeve të lëndëve të para	Numri i dokumentit shoqërues	100 Kg/HL (5)	Gradë	Totali i gradëve alkoolike
Bërsi						
Llumra						
Verë						



Data

Distiluesi

.....

(1) Dëshmia e dorëzimit plotësohet në tre kopje: e para lëshohet deri më 30 shtator të çdo viti për secilin prodhues dorëzues; e e dyta i dërgohet me email zyrtar, në momentin e lëshimit, zyrës rajonale kompetente të autoritetit përgjegjës për ushqimin në lidhje me vendndodhjen e prodhuesit dorëzues; e treta ruhet në arkivin e distilerisë.

(2) Të shënohen të dhënat e plota të personit ose subjektit, përfshirë edhe NUIS.

(3) Të pjestheme ose të plotë (të specifikohet rubrika përkatëse) dhe viti i referencës.

(4) Është e mundur të përgatiten dëshmi të veçanta për çdo lloj produkti (bërësi, llumëra dhe verë).

(5) Pesha në momentin e mbërritjes.